



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Seanca e plenare e Kuvendit
SP-023
Prishtinë, më 8 mars 2018, në orën 10:00

P R O C E S V E R B A L

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 8 MARS 2018**

Seancën e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga Xhavit Haliti, Mufera Shinik dhe Kujtim Shala, nënkryetarë të Kuvendit.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare, sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 5 mars 2018.

Në fillim të seancës, kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli, në emër të tij dhe të deputetëve të Kuvendit, uroi 8 Marsin - Ditën Ndërkombëtare të Gruas.

Më pas, seanca i vazhdoi punimet me pikën e vetme të rendit të ditës:

1. Debat parlamentar në lidhje me dhunën në familje dhe adresimin institucional

Kryetari i njoftoi të pranishmit me kërkesën e deputetes Fatmire Kollçaku, e mbështetur edhe nga 8 deputetë nënshkrues nga GP i Lëvizjes “Vetëvendosje”, për debat parlamentar lidhur me dhunën në familje dhe adresimin institucional.

Kryetari ia dha fjalën deputetes Fatmire Kollçaku, që në emër të propozuesit ta paraqesë çështjen për të cilën është kërkuar debati parlamentar.

Deputetja Fatmire Kollçaku, në emër të parashtresëve të kërkesës për debat parlamentar, tha se dhuna në familje përbën shkelje të të drejtave të njeriut, derisa kjo shkelje ka ndikuar në mbrojtjen e të drejtës së personit për jetën, të drejtën për mjete efektive të garantuara me konventën ndërkombëtare dhe Kushtetutën.

Ajo tha, se janë bërë dhjetë vite nga hyrja në fuqi e ligjit kundër dhunës në familje dhe nga viti 2008 e deri me sot, më shumë se 15 gra janë vrarë, mbi 20 mijë gra kanë raportuar dhunën në familje, ndërsa mbi 68 për qind e grave kanë përjetuar dhunë në forma të ndryshme.

Ajo theksoi, se “jemi të sigurt se drejtësia për secilën grua është e vonuar, me vet faktin se sa lëndë janë trajtuar nga ana e drejtësisë. Edhe ato pak raste që janë trajtuar, vendimet kanë qenë shumë të buta në krahasim me krimin e bërë në familje. Statistikat mbi dhunën në familje e dëshmojnë këtë gjendje. Nga janari deri në dhjetor 2017 janë evidentuar 1196 raste të dhunës në familje”.

Diskutimi i plotë i deputetes Fatmire Kollçaku është i dhënë në transkript.

Më pas, kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, tha se Qeveria e Kosovës do të jetë përkrah familjeve për ta ndalë dhunën në mesin e tyre. Ai shtoi se Qeveria dhe institucionet në përgjithësi, e ndjejnë përgjegjësinë dhe barrën që iu takon, si dhe detyrat që ato kanë para vetes, në mënyrë që dhuna në familjet tona të ndalet dhe të mos ndodhë më.

Diskutimi i plotë i Kryeministrit Haradinaj është i dhënë në transkript.

Lidhur me dhunën në familje dhe adresimin institucional, diskutuan deputetët: Albulena Haxhiu, në emër të GP të LVV-së; Lirije Kajtazi, në emër të GP të LDK-së; Mexhide Mjaku-Topalli, në emër të GP të PDK-së; Teuta Haxhiu, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP të “Nisma për Kosovën”; Jasmina Zhivkoviq, në emër të GP të Listës Serbe; Fikrim Damka, në emër të GP “6+”; Time Kadrijaj, Ganimete Musliu, Drita Millaku, Avdullah Hoti, Sala Berisha-Shala, Albulena Balaj-Halimaj, Emilija Rexhepi, Arbër Rexhaj, Albin Kurti, Mirjeta Kalludra, Luljeta Veselaj-Gutaj, Milaim Zeka, Saranda Bogujevci, Hykmete Bajrami, Xhevahire Izmaqi, Donika Kadaj-Bujupi, Vjosa Osmani-Sadriu, Evgjani Thaçi-Dragusha, Fitore Pacolli-Dalipi, Besa Gaxherri, Blerta Deliu-Kodra, Ismajl Kurteshi, Safete Hadërgjonaj, Mimoza Kusari-Lila, Shemsi Sylja, Korab Sejdiu, Bekim Haxhiu, Fisnik Ismaili, Armend Zemaj, Nait Hasani, Rexhep Selimi, Lumir Abdixhiku, si dhe z. Skender Reçica, ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale, znj. Albena Reshitaj, ministre e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe z. Abelard Tahiri, ministër i Drejtësisë, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryetari e ftoi deputeten Fatmire Kollçaku, t'i paraqesë rekomandimet lidhur me debatin parlamentar.

Deputetja Fatmire Kollçaku, në emër të propozuesve të çështjes, i paraqiti rekomandimet e harmonizuara me grupet parlamentare.

Kryetari konstatoi se në mungesë kuorumit për vendimmarrje, për procedimin e votimit të këtyre rekomandimeve të propozuara nga deputetja Fatmire Kollçaku, do të bëhet pasi të vendosë Kryesia e Kuvendit lidhur me këtë çështje.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës plenare në orën 18:00.

Kryetari i Kuvendit:
Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:
Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale*